

Drin ALIU

KONTRIBUTI I MEDRESESË “ALAUDDIN” NË STREHIMIN E STUDENTËVE SHQIPTARË GJATË VITIT 1990 PAS DËBIMIT NGA UNIVERSITETI DHE KONVIKTET NGA REGJIMI SERB

Një historik i shkurtër i Medresesë “Alauddin” në Prishtinë

Medreseja e Ulët shqiptare (“Alauddin”) u hap dhe e filloi punën e saj edukativo-arsimore më 01.11.1951 në qytetin e Prishtinës. Medreseja e Ulët shqiptare funksiononte në kuadër të institucionit të Bashkësisë së Fesë Islame (BFI). Kjo shkollë fetare filloi veprimtarinë e saj edukativo-arsimore në kohën më të vështirë në të cilën po kalonte populli shqiptar në përgjithësi, arsimi kombëtar dhe arsimi fetar në veçanti. Me gjendjen e vështirë që po dominonte në atë kohë në Kosovës u përballë edhe medreseja e sapothemeluar, mësimdhënësit dhe nxënësit e saj. Krahas kushteve të vështira, kurajo dhe vullneti për të vazhduar procesi edukativo-arsimor në gjuhën shqipe ishte shumë i madh, si nga ana e mësimdhënësve, ashtu edhe nga ana e nxënësve.¹

Gjatë viteve të para të punës si rezultat i mungesës së kuadrit të ri, në Medrese punuan mësimdhënësit e vjetër që kishin shërbyer në medresetë e mëhershme në Kosovë të cilat ishin mbyllur në mënyrë të padrejtë nga regjimi serbo-jugosllav në vitin 1948. Mësimdhënësit në fjalë, ishin njerëz të ditur, njohës të disa gjuhëve, kishin përvojë pune dhe ishin atdhetarë të shquar. Mësimdhënësit e medresesë edhe pse në kushte të disfavorshme punuan shumë me të vetmin qëllim, edukimin dhe arsimimin e gjeneratave të reja në frymën kombëtare dhe fetare.² Si rezultat i vullnetit dhe përkushtimit, krahas kushteve shumë të vështira dhe pengesave të ndryshme, Medreseja e Ulët e Prishtinës zhvilloi një veprimtari sa të vështirë aq edhe të suksesshme mes

¹ Drin Aliu, *Pasqyrë e shkurtër e arkivit (fondit arkivor) të Medresesë së Mesme “Alauddin” në Prishtinë (1984-1997)*, Dituria islame, Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore, nr. 393, (Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, 2023), 49.

² I. Lanza (Feti Mehdiu), *“Pasqyrë e shkurtër e veprimtarisë së Medresesë në Prishtinë - Me rastin e 20-vjetorit”*, në: Edukata islame nr. 15-16, Kryeredaktor: Sherif Ahmeti, Prishtinë: Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës së Ylemave për RSS, 1976, 86.

viteve 1951-1962 duke nxjerrë gjithsej 115 nxënës të diplomuar.³

Mes viteve 1951-1962 përderisa Medreseja ishte shkollë e ulët mësoheshin këto lëndë fetare: Kuran, Histori Islame, Fikh (jurisprudenca islame), Akaid (bazat e fesë), Imamat (metodat dhe shkathtësitë për ushtrimin e detyrës së imamit-hoxhës), Ahlak (edukatë fetare). Ndërsa prej lëndëve të përgjithshme mësoheshin: Historia, Gjeografia, Kimia, Fizika, Matematika, Zoologjia, Botanika, Vizatimi, Higjiena, Edukatë Fizike dhe Lënda e Paraushtarakut (përgatitjeve dhe shkathtësive ushtarake). Po ashtu, në Medrese krahas gjuhës shqipe mësoheshin edhe disa gjuhë të huaja, si: gjuha arabe, gjuha turke, gjuha serbe, bukurshkrimi, drejtshkrimi arabisht dhe drejtshkrimi turqisht. Sipas përqindjes, 46% ishin lëndë të përgjithshme, 25% lëndë fetare dhe 29% lëndë gjuhësore.⁴ Si rezultat i përkushtimit të Bashkësisë së Fesë Islame, drejtorëve, mësimdhënësve dhe nxënësve të saj, kjo shkollë arrit me shumë sukses t’i përballonte sfidat e kohës. Ajo që mund të themi në përgjithësi është se roli i Medresesë së Ulët në procesin edukativo-arsimor në Kosovë mes viteve 1951-1962 ishte shumë i rëndësishëm për kohën sepse ndikoi drejtpërsëdrejti në shkollimin e disa gjeneratave si në aspektin fetar ashtu edhe në atë kombëtar duke vepruar kështu pozitivisht edhe në uljen e numrit të analfabetizmit dhe në ngritjen e vetëdijes kombëtare.

Medreseja e Ulët që nga themelimi ishte dhe shërbente si shkollë e mesme e ulët katërvjeçare. Si pasojë e mungesës së një shkolle të mesme të lartë fetare, nxënësit shqiptarë nga Kosova detyroheshin të vijonin shkollimin e mesëm fetar në Sarajevë në Medresenë “Gazi Husrev Beg” e cila njëherit ishte edhe medreseja e mesme e lartë e vetme në Jugosllavi. Si rezultat i nevojës shumë të madhe që edhe shqiptarët, krahas boshnjakëve, të kishin një shkollë të mesme të lartë fetare, BFI i bëri të gjitha përgatitjet e duhura që Medreseja e Ulët të shndërrohej në medrese të mesme. Pas 11 vjetëve punë, përkushtim dhe sakrificë, Medreseja e Ulët dha rezultate shumëdimensionale duke hedhur kështu edhe themelet e Medresesë së Mesme “Alauddin”. Si rezultat i nevojës imediate me iniciativën e BFI-së, Medreseja e Ulët e Prishtinës në vitin shkollor 1962/1963 u shndërrua në Medrese të Mesme dhe e mori emrin “Alauddin” si rezultat i afërsisë që kishte me Xhaminë

³ Resul Rexhepi, “Medreseja e Mesme “Alauddin” në shtratin e traditës dhe roli i saj për shkollimin e kuadrit fetar”, në Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët; Simpozium ndërkombëtar i mbajtur në Prishtinë më 16.16.17 tetor 1992, Kryeredaktor: dr. Muhamet Pirraku, (Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, 1995), 555.

⁴ Shemsi Rrahimi, “Plan-programi mësimor në Medresenë “Alaudin”, 1951-2016”, në: Medreseja “Alaudin” e Prishtinës: 65 vjet në shërbim të arsimit fetar dhe kombëtar: përmbledhje kumtesash nga Konferenca shkencore, (Prishtinë, 17-19 maj 2017), Përgatiti për botim Ramadan Shkodra, Sadik Mehmeti, (Prishtinë: Dituria Islame, 2018), 541-542.

"Alauddin". Sikurse Medreseja e Ulët Shqiptare edhe Medreseja e Mesme "Alauddin" (e cila u ngrit mbi themelet e Medresesë së Ulët shqiptare) vazhdoi veprimtarinë e saj edukativo-arsimore me plan-program dhe me lëndë të ngjashme vetëm se informacionet ishin më të zgjeruara sepse edhe niveli i shkollimit ishte i më i lartë. Medreseja e Mesme "Alauddin" në Prishtinë që nga hapja e saj kontribuoi vazhdimisht në edukimin dhe arsimimin e gjeneratave të reja si në aspektin fetar ashtu edhe në atë kombëtar në kohën më të vështirë që po kalonte vendi dhe populli shqiptar.⁵

Medreseja "Alauddin" si institucion edukativo-arsimor ngërthente në vete shumë komponentë të veçantë dhe specifikë gjë që e dallonin nga shkollat e tjera të kohës, duke filluar nga vizioni, kuadri profesional, kombinimi i plan-programeve mes lëndëve fetare dhe lëndëve të përgjithshme, disiplina, cilësia, kompaktësia etj., të gjitha këto dhe shumë elemente të tjera e bënë këtë shkollë unike dhe fanar ndriçues dhe shembull për shkollat e tjera të kohës. Medreseja "Alauddin" me veprimtarinë e saj të larmishme dha një kontribut shumëdimensional në përgjithësi në zhvillimin e procesin edukativo-arsimor në veçanti, duke ndikuar kështu drejtpërsëdrejti në formësimin e një shtrese intelektuale fetare e kombëtare në Kosovë dhe më gjerë. Padyshim një kontribut shumë të madh në këtë drejtim dhanë edhe drejtuesit dhe mësimeve në këtë shkollë të cilët punuan intensivisht në kushte aspak të lehta me të vetmin qëllim zhvillimin dhe avancimin e arsimit. Në Medresenë "Alauddin" u shkolluan dhe edukuan shumë gjenerata në një kohë shumë të vështirë në të cilën po kalonte vendi dhe arsimit në gjuhën shqipe. Krahas të gjitha vështirësive, si rezultat i punës progresive kjo shkollë arriti që t'i përballonte të gjitha sfidat e kohës dhe të kontribuonte shumë në kultivimin e vlerave fetare e kombëtare në përgjithësi dhe në përhapjen e mësimeve në gjuhën shqipe në veçanti.⁶

Kontributi i Medresesë "Alauddin" në strehimin e studentëve shqiptarë gjatë vitit 1990 pas dëbimit nga Universiteti dhe konviktet nga regjimi serb

Medreseja "Alauddin" e Prishtinës që nga themelimi i saj ka dhënë një kontribut konstruktiv dhe shumëdimensional si në procesin edukativo-arsimor ashtu edhe në aspektin kombëtar shqiptar. Kontributi i Medresesë ka

⁵ Drin Aliu, *Roli i Medresesë "Alauddin" në procesin edukativo-arsimor në Kosovë mes viteve 1951-1999*, (Prishtinë, 2021), 52-53.

⁶ Më gjerësisht shih: Aliu, *Roli i Medresesë "Alauddin" në procesin edukativo-arsimor në Kosovë*.

qenë i madh dhe i vazhdueshëm në përgjithësi, gjatë viteve të '90-ta në veçanti.⁷ Pas suprimimit në mënyrë të padrejtë të Autonomisë së Kosovës në vitin 1989 nga ana e Serbisë, për shqiptarët e Kosovës filloi një jetë e rënduar në çdo aspekt. Regjimi serbo-sllav përdori masa shtypëse duke u mohuar shqiptarëve të drejtat elementare. Nga këto masa shtypëse pësuan të gjitha institucionet në përgjithësi, institucionet edukativo-arsimore në veçanti. Meqenëse shqiptarët i kundërshtuan masat e regjimit në forma të ndryshme duke mos i pranuar ato, regjimi serb si hakmarrje e shtoi edhe më tej presionin dhe shtypjen ndaj popullit në forma të ndryshme. Në fillim të viteve të '90-ta, krahas shumë masave që mori regjimi serb kundër shqiptarëve ishte edhe largimi me dhunë i nxënësve nga objektet shkollore⁸ dhe i studentëve nga Universiteti i Prishtinës dhe konviktet.

Medreseja “Alauddin” në Prishtinë dha kontribut në forma të ndryshme edhe gjatë kësaj kohe shumë të vështirë në të cilën po kalonte arsimi në gjuhën shqipe, veçanërisht pas dëbimit të dhunshëm që regjimi serb ndërmoi ndaj nxënësve, studentëve dhe mësimeve shqiptarë nga objektet shkollore dhe fakultetet. Këtë kontribut kjo shkollë e dha në forma të ndryshme. Ndihej që Medreseja “Alauddin” dha për Universitetin e Prishtinës dhe studentët e tij dëshmohej më së miri përmes dokumenteve arkivore që gjenden në Arkivin e kësaj shkolle. Në Raportin e punës së Medresesë “Alauddin” për vitin shkollor 1991/1992, dëshmohej ndihma që Medreseja “Alauddin” i ofroi disa fakulteteve të Universitetit të Prishtinës. Ndër të tjera në faqen 5 të raportit në fjalë potencohet fakti se: *“Medreseja gjatë vitit shkollor 1991/92 ndihmoi dhe mundësoi regjistrimin e studentëve të disa fakulteteve duke iu ofruar lokalet e veta. E këtu mbajtën provime disa profesorë nga Fakulteti Filologjik, Ekonomik, Juridik, ai i Arkitekturës, i Elektros, i Makinerisë, i Ndërtimtarisë e tjerë. Në lokalet e kësaj Medreseje në mënyrë solemne diplomuan 6 inxhinierë të rinj nga Fakulteti i Ndërtimtarisë, Arkitekturës, Makinerisë dhe Elektros”*.⁹ Në Medrese u

⁷ Në këtë punim të shkurtër dhe konstruktiv do të trajtojmë vetëm kontributin e Medresesë “Alauddin” në strehimin e studentëve shqiptarë pas masave të dhunshme të regjimit serb. Më gjerësisht rreth historikut të shkollës dhe kontributeve të saj në aspektin edukativo-arsimor dhe në aspektin kombëtar shih: Drin Aliu, *Roli i Medresesë “Alauddin” në procesin edukativo-arsimor në Kosovës mes viteve 1951-1999*, (Prishtinë, 2021), 34-87.

⁸ Më gjerësisht rreth arsimit në Kosovë gjatë viteve të '90-ta shih: Bajram Shatri, *Arsimi shqip në Kosovë, 1990-1999: shtëpitë shkolle, sfidat, arritjet dhe aspiratat*, (Prishtinë: Libri Shkollor, 2010).

⁹ Arkivi i Medresesë së Mesme “Alauddin” Prishtinë (më tej do të paraqitet me shkurtesën AMMAP), Fondi: Veprimtaria e Medresesë “Alauddin” mes viteve 1991-1992 (dokumente të parregulluara-paklasifikuara), viti 1992, fleta 5, Kutia nr. 5, *Raporti i punës së Medresesë*

mbajtën edhe disa mbledhje të Universitetit të Prishtinës, veçohet mbledhja e datës 26 nëntor 1991 në të cilën u vendos që Universiteti i Prishtinës të fillonte punën në shtëpi-shkolla. Pastaj veçohet mbledhja e datës 10 dhjetor 1991 në të cilën u miratua plan-programi dhe u zgjodh rektori i UP-së, Ejup Statovci¹⁰ etj.

Krahas ndihmave të shumta që Medreseja “Alauddin” dha ndaj Universitetit të Prishtinës, veçohet ndihma që Medreseja “Alauddin” dha për strehimin e studentëve shqiptarë të cilët u dëbuan nga fakultetet dhe konviktet nga ana e regjimit të dhunshëm serb. Lidhur me këtë çështje, studiuesi Bajram Shatri pohon se: *“Me rastin e dëbimit të studentëve nga konviktet (dhe fakultetet D.A) në vitin 1989, solidariteti i popullatës së Prishtinës ishte shumë i lartë. Këtu prapë duhet veçuar Medresenë “Alauddin” të Prishtinës, përgjegjësit e së cilës i strehuan studentët e shumtë, të cilët kishin ngelur rrugëve, duke u siguruar strehim, ushqim, dhe përkujdesje prindërore”*.¹¹

Gjatë vitit akademik 1990/1991 konvikti i Medresesë “Alauddin” ishte i stërmbushur duke akomoduar shumë studentë nga të gjitha fakultetet e Universitetit të Prishtinës. Krahas studentëve nga Kosova, ishin strehuar edhe disa studentë shqiptarë që jetonin në pjesë të ndryshme të ish-Jugosllavisë të cilët studionin në fakultetet të ndryshme të Universitetit të Prishtinës. Siç shihet Medreseja “Alauddin” kishte rol konstruktiv edhe në mbarëvajtjen e arsimit të lartë në Kosovë në kohën më të vështirë që po kalonte Universiteti i Prishtinës. Këto dhe shumë veprime të tjera të formave të ndryshme tregojnë qartë se medreseja ishte vatër gjithnjë në shërbim të procesit edukativo-arsimor. Studentët filluan që të vendoseshin në Konviktin e Medresesë “Alauddin” që nga data 20 mars 1990.¹² Krahas 214 studentëve të regjistruar në konvikt, sipas ish-drejtorit të atëhershëm të Medresesë “Alauddin”, Resul Rexhepi (i cili së bashku me personelin e shkollës kishin dhënë kontribut

së mesme “Alud-din” në Prishtinë për vitin shkollor 1991/92.

¹⁰ Bujar Dugolli, *“Lëvizja studentore 1997/1999 dhe Medreseja “Alaudin”: Historia e një bashkëpunimi në mbrojtje të Universitetit të Prishtinës”*, në: Medreseja “Alaudin” e Prishtinës: 65 vjet në shërbim të arsimit fetar dhe kombëtar: përmbledhje kumtesash nga Konferenca shkencore, (Prishtinë 17-19 maj 2017), Përgatiti për botim Ramadan Shkodra, Sadik Mehmeti, (Prishtinë: Dituria islame, 2018), 421-423.

¹¹ Bajram Shatri, *“Kontributi i Medresesë “Alaudin” në mbijetesën e arsimit shqip në Kosovë në periudhën e viteve 1990-1999”*, në: Medreseja “Alaudin” e Prishtinës: 65 vjet në shërbim të arsimit fetar dhe kombëtar: përmbledhje kumtesash nga Konferenca shkencore, (Prishtinë 17-19 maj 2017), Përgatiti për botim Ramadan Shkodra, Sadik Mehmeti, (Prishtinë: Dituria islame, 2018), 392.

¹² AMMAP, Fondi: Veprimtaria e Medresesë “Alauddin” mes viteve 1990-1991 (dokumente të parregulluara-paklasifikuara), viti 1990, fleta 2, Kutia nr. 4, *Procesverbali i mbledhjes së Këshillit arsimor-edukativ të Medresesë së Mesme “Alauddin” 26.03.1990.*

shumë të madh në strehimin e studentëve) numri i studentëve ishte edhe më i madh, kjo për faktin se studentët e strehuar në konviktin e Medresesë në shumicën e rasteve sjellin edhe shokë nga jashtë. Sipas tij, këtë rritje të numrit të studentëve e kanë vërejtur personeli i kuzhinës në bazë të shujtave ushqimore që shpërndareshin tri herë në ditë pa pagesë për studentët e strehuar. Këtë rritje të numrit të studentëve e ka toleruar drejtorja e shkollës duke pasur parasysh situatën e vështirë që po kalonte vendi dhe studentët. Lidhur me strehimin e studentëve në Konviktin e Medresesë, ish-drejtori Resul Rexhepi shprehet me modesti se: *“Ne nuk kemi bërë asgjë më shumë se që e kemi pas obligim për ta bërë, se ata kanë qenë bijë të këtij populli. Ishte shumë meritore që ardhmërinë e vendit tonë ta strehojmë, qoftë edhe përkohësisht”*.¹³ Padyshim ky ishte një veprim shumë i madh dhe i guximshëm përkundër rreziqeve që i kanoseshin Medresesë nga regjimi serb.

Si rezultat i veprimtarisë kombëtare Medreseja “Alauddin” disa herë me radhë u rrethua dhe u vandalizua nga forcat policore serbe¹⁴, por veprimtaria e saj edukativo-arsimore dhe kombëtare ishte e lidhur ngushtë me fatin e Kosovës, siç pohon me të drejtë akademiku Rexhep Qosja *“Ditët e mira të saj ishin ditët e mira edhe të Kosovës e ditët e vështira të saj ishin ditët e vështira edhe të Kosovës”*.¹⁵ Të gjitha këto dhe shumë kontribute të tjera të Medresesë “Alauddin” e bëjnë këtë institucion të pandarë nga historia e çlirimit dhe shtetndërtimit të Kosovës.

Duke u bazuar në dokumentacionin arkivor do ta publikojmë dhe botojmë për herë të parë listën e studentëve që ishin strehuar-akomoduar në Konviktin e Medresesë “Alauddin” të Prishtinës, si dëshmi e detajuar për këtë kontribut e kësaj shkolle në strehimin e studentëve.

¹³ Intervistë me ish-drejtorin e Medresesë së Mesme “Alauddin”, Resul Rexhepi, (26.02.2022).

¹⁴ Më gjerësisht shih: Gazeta “Bujku”, Prishtinë, 24, 25 dhe 26 qershor 1992.

¹⁵ Rexhep Qosja, *“Përvjetor shumë i rëndësishëm”*, në: Medreseja “Alaudin” e Prishtinës: 65 vjet në shërbim të arsimit fetar dhe kombëtar: përmbledhje kumtesash nga Konferenca shkencore, (Prishtinë 17-19 maj 2017), Përgatiti për botim Ramadan Shkodra, Sadik Mehmeti, (Prishtinë: Dituria Islame, 2018), 25.

Lista e studentëve të strehuar (akomoduar) në Konviktin e Medresesë së Mesme “Alauddin” në Prishtinë gjatë vitit akademik 1990/91

KATI I PARË

Emri dhe mbiemri	Vendi	Komuna	Nr. Inj.	Fakulteti (Drejtimi)	Numri i indeksit	Numri i dhomës
1.Fadil Zuka	Pozhoran	Viti	20656	Mjekësi	2804/80	108
2.Ismet Uruqi	Gjilan	Gjilan	73150	Mjekësi	3581/82	108
3.Blerim Bajrami	Gjilan	Gjilan	133291	Mjekësi	3119/82	108
4.Abdullatif Latifi	Topanicë	Gjilan	20039	Mjekësi	4512/85	108
5.Zylbehar Bajrami	Gjilan	Gjilan	31460	Mjekësi	4725/82	105
6.Behar Uka	Gjilan	Gjilan	60577	Mjekësi	3496/82	105
7.Muhibi Dauti	Lubishtë	Viti	26275	Bujqësi	1969/85	106
8.Avni Misini	Gjylekar	Viti	29309	Bujqësi	408/89	106
9.Muhamed Misini	Gjylekar	Viti	34734	Bujqësi	505/89	106
10.Ruzhdi Frangu	Sllatinë	Viti	21956	Bujqësi	3769	106
11.Fahri Ukaj	Kaliçan	Istog	34713	Elektro	43/89	101
12.Besim Ymeri	Sllatinë	Viti	39213	Elektro	39-86	101
13.Izet Sadrujaj	Prizren	Prizren	82985	Ekonomik	15653/88	101
14.Xhemshit Smajli	Sran	Mitrovica e Titos	50205	Sh.l.m	1133/89	101
15.Abdulla Rukiqi	Vërbovc	Gllgovc	27427	Mjekësi	3484/82	102
16.Muharem Morina	Gllobarë	Gllgovc	14841	Mjekësi	5478/86	102
17.Fatmir Kabashi	Polac	Sërbicë	25947	Mjekësi	4533/84	102
18.Sami Delijaj	Obri	Gllgovc	18215	Mjekësi	5162	102
19.Nexhmedin Bajrami	Gjilan	Gjilan	40589	Bujqësi	7187	103
20.Tahir Tahiri	Sojevë	Ferizaj	60573	Bujqësi	76	103
21.Muhamed Rushidi	Prelez	Ferizaj	77971	Bujqësi	709	103
22.Islam Miftari	Vërban	Viti	24131	Bujqësi	4586	103
23.Habib Elshani	Suharekë	Suharekë	16397	Bujqësi	3847	104
24.Isa Morina	Reshtan	Suharekë	20140	Bujqësi	3651	104
25.Zymer Zeneli	Gjinovcë	Suharekë	19441	Bujqësi	1940	104

26.Zekrija Hoxha	Doganaj	Kaçanik	11812	Bujqësi	3769	104
27.Musa Hasani	Rzhanë	Mitrovicë	36020	Kimi	3309	121
28.Nezir Hasani	Vilikorekë	Podujevë	37681	Fizik	34	121
29.Burim Çeku	Deçan	Deçan	17566	Mjekësi	4359	120
30. Luan Çeku	Deçan	Deçan	26666	Mjekësi	1567	120
31.Adem Idrizi	Zhegër	Gjilan	43694	Juridik	86/105	120
32.Hyzri Haxhani	Mirash	Ferizaj	74819	Juridik	35/87	120
33. Raif Lota	Ivaj	Kaçanik	20510	Filologjik	1958	119
34. Arif Dashi	Stagovë	Kaçanik	19220	Filozofik	26777	119
35.Afrim Berisha	Kaçanik	Kaçanik	18214	Makineri	3/88	119
36.Çerkin Rama	Mitrovicë	Mitrovicë	45882	Kimi	4178	119
37.Fatmir Veseli	Gjilan	Gjilan	45713	Kimi	3330	118
38.Blerim Veseli	Gjilan	Gjilan	44042	Kimi	3339	118
39.Gazmend Syla	Gjilan	Gjilan	45835	Juridik	8613	118
40.Remzi Feka	Karaç	Vushtrri	51056	Juridik	18/85	118
41.Mefail Maliqi	Preshevë	Preshevë	14724	Filologjik	2025	117
42. Fadil Shala	Cërmjan	Gjakovë	79633	Ekonomik	2/15259	117
43.Naim Murati	Çerkezë	Kumanovë	23539	Mjekësi	1610/89	117
44.Triumfal Baruti	Gjakovë	Gjakovë	95498	Mjekësi	6588/89	117
45.Samet Haxhiabdyli	Tetovë	Tetovë	204652	Elektro	398/85	111
46.Mensur Rexhepi	Tetovë	Tetovë	204643	Elektro	125/85	111
47.Emrush Iseni	Tetovë	Tetovë		Makineri	118/82	111
48.Avni Smaili	Pejë	Pejë		Makineri		111
49.Tush Kabashi	Pejë	Pejë	54538	Juridik	85/9	107
50.Gazmend Sharku	Rahovec	Rahovec	23527	Juridik	86/88	107
51.Musa Berisha	Rugovë	Gjakovë	37561	Juridik	278/86	107
52.Binak Cena	Pejë	Pejë	5083	Juridik	217/86	107
53.Esat Rraci	Jellovc	Klinë	26842	Juridik	86/88	112
54.Qemush Brava	Hani i Elezit	Kaçanik	16154	Juridik	50/86	107
55.Xhevdet Shkreta	Hani i Elezit	Kaçanik	23908	Ekonomik	2/15523	112

56.Agim Kuka	Kaçanik	Kaçanik	28655	Juridik	52/86	112
57.Neset Milla	Ulqin	Ulqin	11217	Elektro	403/86	201
58.Sabri Kolenoviq	Zogaj	Ulqin	15657	Makineri	182/85	201
59.Eçrem Kryeziu	Xërxë	Rahovec	26067	Makineri	56/86	201
60.Nexhat Berisha	Rugovë	Gjakovë	96727	Makineri	140/86	201
61. Halil Gashi	Llazicë	Malishevë	21505	Bujqësi	73/87	202
62.Naser Seliman	Pejë	Pejë	64303	Bujqësi	4352/86	202 ¹⁶
		KATI I DYTË				
63.Ismajl Podrimaj	Cërrolluk	Istog	33481	Bujqësi	2092/86	202
64.Agon Çekaj	Irnziq	Deçan	25640	Bujqësi	355/89	202
65.Valon Murtezai	Klinë e U.	Sërbicë	25888	Bujqësi	4276/86	203
66.Enver Kajtazi	Tërnovë	Sërbicë	18274	Bujqësi	18/87	203
67.Skender Aliu	Llapovë	Kumanovë	203093	Bujqësi	233/88	203
68.Gjafer Luma	Gllloboçicë	Kaçanik	21667	Bujqësi	228/88	203
69.Xhevdet Podrimaj	Cerralluk	Istog	34578	Elektro	159/88	204
70.Fazli Osmanaaj	Trobohovc	Istog	36152	Ndërtimtari	131/89	204
71.Nysret Zogaj	Kaliçan	Istog	33127	Mjekësi	1591/89	204
72.Farjedin Ferataj	Gjutakovc	Istog	32863	Ndërtimtari	146/89	204
73.Bajram Mehmeti	Botushë	Gjakovë	94617	Filologjik	1835	205
74.Florim Mehmeti	Botushë	Gjakovë	91157	Bujqësi	495/89	205
75.Xhafer Idrizi	Pejë	Pejë	80927	Juridik	86/09	206
76.Halit Gashi	Janjevë	Lipjan	20074	Juridik	85195	206
77.Arben Koea	Sërbicë	Sërbicë	-----	Elektro	22/88	207
78.Izet Tola	Prizren	Prizren	86908	Elektro	135/88	207
79.Naim Ahmetaj	Banjë	-----	27557	Elektro	474/89	207
80.Milazim Mushkolaj	Deçan	Deçan	25420	Elektro	386/87	207

¹⁶ AMMAP, Fondi: Veprimtaria e Medresesë “Alauddin” mes viteve 1990-1991 (dokumente të parregulluara-paklasifikuara), viti 1990, fleta 1, Kutia nr.4, *Lista e studentëve të akomoduar në Konviktin e Medresesë së Mesme “Alauddin”*.

81.Bejtush Murati	Gjilan	Gjilan	32919	Mjekësi	4804/85	208
82.Blerim Sadikaj	Istog	Istog	3066	Mjekësi	4422/84	208
83.Afrim Sadikaj	Istog	Istog	-----	Mjekësi	----- --	208
84.Gazmen Kajtazaj	Istog	Istog	-----	Mjekësi	----- --	208
85.Ekrem Rafuna	Gjilan	Gjilan	27344	Elektro	117/84	209
86.Selman Latifi	Gjilan	Gjilan	73451	Bujqësi	2206	209
87.Shaqir Ahmeti	Mitrovicë	Mitrovicë	57218	Makineri	139/89	209
88.Hysen Neziri	Remnik	Viti	28734	SHLP	767	209
89.Enver Regjepi	-----	-----	-----	Biologji	-----	210
90.Bajram Mustafa	Tupall	Medvegje	17969	Bujqësi	3755	211
91.Shaban Konesna	Karaçevë	Kamenicë	28651	Bujqësi	22788	211
92.Naser Kadriu	Bellopojë	Podujevë	36135	Makineri	150/85	211
93.Skënder Istogu	Gllgovc	Gllgovc		Ekonomik		211
94.Isuf Krasniqi	Hoçë e Vogël	Rahovec	24206	Mjekësi	600/987	213
95.Shkëlzen Murseli	Gjakovë	Gjakovë	100242	Mjekësi	1375/87	213
96.Besnik Rama	Mulliçi	Deçan	-----	Mjekësi	-----	213
97.Burim Berisha	-----	-----	-----	-----	1233/86	213
98.Fatmir Hoti	Carralluk	Malishevë	8796	Ekonomik	2/15716	214
99.Xhavit Marmullaku	Doshë	Klinë	28771	Filozofik	2291	214
100.Agron Haliti	Mitrovicë	Mitrovicë	26778	Ekonomik	2/15122	214
101.Shpejtim Sertolli	Bellanicë	Malishevë	11096	Ekonomik	2/15130	214
102.Azem Tershani	-----	-----	-----	Mjekësi	-----	215
103.Sejdi Salihu	-----	Shtime	27015	Juridik	237/88	215
104.Ismet Rrahmani	Gumnishtë	Gjilan	79550	Juridik	40/88	215
105.Muharrem Tershani	-----	-----	-----	Juridik	-----	215
106.Azem Tërshani	-----	Suharekë	-----	Mjekësi	-----	215

107.Lulzim Mulliqi	Rushiqë	Pejë	77645	Makineri	126/87	216
108.Mentor Mulliqi	Rushiqë	Pejë	80955	Mjekësi	6809/88	216
109.Blerim Koca	Sërbicë	Sërbicë	18344	Kimi	3175	217
110.Fadil Hoti	Sërbicë	Sërbicë	16887	Kimi	2881	217
111.Illir Koci	Polac	Sërbicë	28610	Kimi	2810	217
112.Mentor Miftari	Runik	Sërbicë	-----	Biologji	-----	217
113.Tahir Jakupi	Rahovicë	Ferizaj	49647	Ndërtimtari	-----	218
114.Izja Bityqi	Mirosllavë	Ferizaj	47698	Makineri	163/88	218
115.Naim Hasani	Papaz	Ferizaj	55536	Ndërtimtari	164/84	218
116.Fitim Çerkini	-----	Shkup	-----	Ndërtimtari	-----	218
117.Hajrullah Agjani	Shkup	Shkup	987937	Filozofi	2950	219
118.Naim Agjani	-----	-----	-----	Ekonomik	-----	219
119.Azem Sopa	-----	-----	-----	Juridik	-----	219
120.Hesat Agjani	-----	-----	-----	Ekonomik	-----	219
121.Feriz Llapi	Istog	Istog	17503	Bujqësi	393/89	220
122.Tahir Maraj	-----	-----	-----	Bujqësi	-----	220
123.Gëzim Maraj	-----	-----	-----	Filozofik	-----	220
124.Driton Zylfiu	Tugjefcë	-----	-----	Mjekësi	-----	220
125.Veton Gojani	Radulloc	Klinë	35269	Mjekësi	5320/86	212
126.Xhevahir Selmanaj	Radulloc	Klinë	21823	Mjekësi	-----	212
127.Afrim Berisha	Pejë	Pejë	85026	Elektro	-----	212
128.Ramiz Hoxha	Deçan	Deçan	18876	FSHMN	-----	212
129.Shukri Krasniqi	Tugjec	Kamenicë	32692	Makineri	137/69	221
130.Bajram Nuhiu	Tugjec	Kamenicë	-----	-----	-----	221
		KATI I	TRETË			
131.Xhemajl Abazi	Preshevë	Preshevë	33520	Mjekësi	1224/86	309
132.Beqir Abazi	Preshevë	Preshevë	-----	-----	-----	309

133.Afrim Cana	Gjilan	Gjilan	-----	-----	-----	309
134.Sadik ----	Gjilan	Gjilan	-----	-----	-----	309
135.Haki Tolaj	Deçan	Deçan	22813	Makineri	85/87	308
136.Arben Musliu	-----	-----	-----	Bujqësi	-----	308
137.Ahmet Jahmurataj	Lubeniç	Pejë	57864	Ndërtimtari	13/84	307
138.Avdirahman Berisha	Këq	Mitrovicë	24419	SHLP	935/89	307
139.Enver Istogi	Polluzh	Gllgovc	21630	SHLP	930/89	307
140.Mustaf Mehana	Krasn.	Vuçitërnë	-----	SHLP	-----	307
141.Ibrahim Krasniqi	Karaçevë	Kamenicë	27148	Fizik-Kimi	04/87	306
142.Faik Avdyli	Leshtar	Kamenicë	25047	Bujqësi	10/87	306
143.Rezhep Zulfu	Kopernicë	Kamenicë	25052	Bujqësi	4259/86	306
144.Rufki Suma	Kaçanik		-----	Juridik	-----	306
145.Sllami Kokullari	Budakovc	Suharekë	24575	Makineri	182/86	301
146.Fadil Ibraj	-----	-----	-----	Teknik	-----	301
147.Safet Kokullari	Budakovc	Suharekë	-----	Teknik	-----	301
148.-----	-----	-----	-----	-----	-----	---
149.Milaim Sokoli	Rahovec	Rahovec	21226	Elektro	245/84	302
150.Hamdi Korenica	Rahovec	Rahovec	17443	Elektro	186/82	302
151.Bashkim Kadir	Rahovec	Rahovec	18050	Makineri	300/84	302
152.Ajet Musa	-----	Leposaviq	-----	Elektro	-----	302
153.Fitim Rrustaj	Pejë	Pejë	96642	Elektro	330/85	303
154.Reshat Spahiu	Opterush	Rahovec	23157	FSHMN	2473	303
155.Hafet Alijaj	Sllatinë	Kaçanik	18542	Ndërtimtari	210/89	303
156.Isuf Nimani	Pejë	Pejë	-----	Makineri	-----	303
157.Nexhat Osaj	Mitrovicë	Mitrovicë	19984	Makineri	59/88	304
158.Xhemë Xhuli	Junik	Deçan	16963	Ndërtimtari	239/86	304
159.Skender Haklaj	Isnqi	Deçan	17626	Ndërtimtari	299/85	309
160.Halil Veliqi	-----	Sërbicë	-----	Ndërtimtari	-----	309

161.Dervish Krasniqi	Prapaçan	Deçan	23814	Makineri	51/87	316
162.Faruk Berisha	Majac	Podujevë	57582	Makineri	44/89	316
163.Xhevdet Bytyqi	Suharekë	Suharekë	38783	Filologjik	806/--	315
164.Illir Krusha	Prizren	Prizren	86068	Mjekësi	6502/89	315
165.Isuf Xhemali	Bajqinë	Podujevë	70537	Filologjik	719	315
166.Nexhat Çoçaj	Gjonaj	Prizren	-----	-----	-----	315
167.Milaim Kosumi	Gjilan	Gjilan	46849	Mjekësi	24/4563	314
168.Besnik Slihu	Pejë	Pejë	67800	-----	79/81	314
169.Sami Kelmendi	Pejë	Pejë	35432	-----	79/81	314
170.Hamid Bashota	Llapashtic	Podujevë	55480	Elektro	55/89	313
171.Feim Muqolli	Hertic	Podujevë	50135	Mjekësi	6430/89	313
172.Mexhit Taç	Mamush	Prizren	124593	Turkologji	24	313
173.Afrim Pelaj	Novosellë	Pejë	94334	Elektro	3/89	313
174.Skender Votaj	Samadrexhë	Suharekë	21367	Ndërtimtari	66/89	312
175.Rushdi Shtërbuni	Reti	Rahovec	12118	Teknik	552/83	312
176.Sadri Jonuzi	Mushtisht	Suharekë	15863	Makineri	208/83	312
177.Kader Vogël	Prizren	Prizren	84433	Teknik	312	312
178.Bekim Guda	Gjilan	Gjilan	53393	Ekonomik	2/15057	311
179.Arben Musliu	Gjilan	Gjilan	-----	Bujqësi	-----	311
180.Bedri Kryeziu	Prizren	Prizren	122644	Ekonomik	2/15600	311
181.Sami Kryeziu	Pagarushë	Prizren	122043	Ekonomik	2/15601	311
182.Ramiz Kallamaku	Jashanicë	Klinë	31776	SHLP	829/88	317
183.Naim Tahiraj	Pejë	Pejë	70696	SHMN	2769	317
184.Qerim Spahiu	Serbic	Vitak	18746	SHMN	2596	317
185.Afrim Lumi	Suharekë	Suharekë	-----	-----	-----	317
186.Naim Lokaj	Prilep	Deçan	2577	Juridik	69/85	318

187.Nazmi Muslijaj	Groberdë	Istog	27759	Juridik	192/85	318
188.Lulëzim Gjonaj	Kodralli	Deçan	19739	Ekonomik	2924744	318
189.Xhelal Mani	Stagovë	Kaçanik	22542	Kimi	4043/89	318
190.Mentor Selmanaj	Istog	Istog	33905	Mjekësi	1906/88	319
191.Naim Abazi	Mitrovicë	Mitrovicë	31879	Bujqësi	1574	319
192.Avni Rushiti	Prelezë	Ferizaj	59730	Arkitekturë	585	319
193.Skender Bahtiu	Komogllavë	Ferizaj	40427	Arkitekturë	14082	319
194.Mehmet Gjonbalaj	-----	-----	-----	Makineri	-----	320
195.Tahir Gjonbalaj	-----	-----	-----	-----	-----	320
196.Ferki Jusufi	-----	-----	-----	Filologjik	-----	321
197.Xhevdet Çerkinaj	-----	-----	-----	Filozofik	-----	321
198.Adem Jaha	-----	Podujevë	-----	Mjekësi	-----	310
199.Besim Beqiri	-----	Podujevë	-----	Mjekësi	-----	310
200.Xhezair Shala	Fushicë	Gllgovc	14919	Juridik	-----	206
201.Demush Neziri	Gadishë	Gjilan	35160	Juridik	-----	206
202.Vesel Maliqi	Busavatë	Kamenicë	37043	Bujqësi	4266	113
203.Lulzim Thaqi	Rogoçicë	Kamenicë	21344	Bujqësi	4194	113
204.Riza Jerliu	Dazhnicë	Kamenicë	23321	Bujqësi	4318	113
205.Milaim Sermaxhaj	Hogosht	Kamenicë	-----	Bujqësi	-----	113
206.Afrim Bytyqi	Kërvasar	Malishevë	27619	Bujqësi	39/87	114
207.Hysen Bytyqi	Kërvasar	Malishevë	27642	Bujqësi	38/87	114
208.Bashkim Bytyqi	Kërvasar	Malishevë	8072	Bujqësi	33/87	114
209.Gjon Thaqi	Jagodë	Klinë	30747	Bujqësi	4202/86	114
210.Elmi Dakaj	Coravik	Klinë	30598	Filozofik	2306	115
211.Bashkim Dakaj	Coravik	Klinë	35424	Filozofik	-----	115
212.Rasim Behrami	Baks	Sërbicë	24362	Juridik	87234	115

213.Orhan Syla	Bresalcë	Gjilan	33059	Ndërtimtari	18284	115
214.Musa Mehaj	Prekaz	Sërbicë	22243	Juridik	8615	116
215.Fatmir Behrami	Baks	Serbicë	17094	Juridik	8592	116 ¹⁷

Duke analizuar me kujdes këtë listë të detajuar (e cila shërben edhe si mostër), mund të bëjmë një mikroanalizë rreth drejtimeve që studentët shprehin interesim më të madh për studim gjatë asaj kohe. Nga 214 studentët e strehuar në Konviktin e medresesë, 53 prej tyre studionin në drejtime të ndryshme në Fakultetin Teknik, 38 në drejtime të ndryshme në Fakultetin e Bujqësisë, 35 studionin në drejtime të ndryshme në Fakultetin e Mjekësisë, 22 në Fakultetin Juridik, 12 studionin në drejtime të ndryshme të FSHMN-së, 9 në Fakultetin Ekonomik, 7 në drejtime të ndryshme të Fakultetit Filozofik, 3 në drejtime të ndryshme të Fakultetit Filologjik, 5 prej tyre ishin pjesë e Shkollës së Lartë Profesionale, 3 nxënës të shkollave të mesme të larta etj.

Siç shihet nga kjo listë edhe pse shumë e vogël në krahasim me numrin e të gjithë studentëve të kohës, numri më i madh i studentëve kishin interesim dhe studionin në drejtime të ndryshme të Fakultetit Teknik, Mjekësisë, Fakultetit të Bujqësisë dhe Juridik, e kështu me radhë. Nga kjo listë supozojmë se, interesimi i studentëve ishte i përqendruar në studimin e fushave më të rëndësishme që i nevojiten një shoqërie dhe vendi.

¹⁷ AMMAP, Fondi: Veprimtaria e Medresesë “Alauddin” mes viteve 1990-1991 (dokumente të parregulluara-paklasifikuara), viti 1990, fleta 1, 2, 3 dhe 4, Kutia nr. 4, *Lista e studentëve të akomoduar në Konviktin e Medresesë së Mesme “Alauddin”*.